Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë

Prishtinë, nëntor 2016

Të drejtat e autorit © 2016. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç citateve të pasazheve të shkurta për qëllime kritike e shqyrtimi, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të mbahet në sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në asnjë formë e nga asnjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetër, pa pëlqimin paraprak të organizatës D4D.

Punimi u përgatit nga:

Bernard Nikaj
Leon Malazogu

Me kontribut nga:

Gulliver Brady

Ky studim është mbështetur nga Projekti i Zyres Zvicrane per Zhvillim dhe Bashkepunim (SDC) “Rritja e Punësimit për të rinj (EYE)”, i implementuar nga konsorciumi HSIK-HELVETAS Swiss Intercooperation në Kosovë dhe MDA - Management and Development Associates. Opinonet, gjetjet dhe përfundimet apo rekomandimet e shprehura ketu janë të autorëve dhe Instituti Demokraci për Zhvillim dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane dhe të implementuesve.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 5

Hyrje 8

Metodologjia dhe audienca 11

Qeverisja e dekurajuar e arsimit të lartë 12
Kuvendi 12
Qeveria 12
Bordi i Universitetit 13
Rektori 13
Dekanët 14
Profesorët 15

Gjendja e tashme në shifra 16

Propozimi 1: Plotësimi i konkurrencës me më shumë hapësirë për politikëbërje 18
Përvojë për krahasim 19
Masat e propozuara 20
Përfitimet 21

Propozimi 2: Modele dinamike financimi të bazuara në performancë 22
Përvojë për krahasim 23
Masat e propozuara 23
Përfitimet 24

Propozimi 3: Përcjellja e performancës 25
Përvojë për krahasim 26
Masat e propozuara 27
Përfitimet 28

Propozimi 4: Tarifat dhe financimet të lidhen me cilësinë e studentëve dhe mundësitë e tyre për të paguar 29
Përvojë për krahasim 29
Masat e propozuara 31
Përfitimet 32

Propozimi 5: Shtim i llogaridhënies nëpër sistemin e arsimit të lartë 33
Përvojë për krahasim 34
Masat e propozuara 35
Përfitimet 35

Propozimi 6: Konkurrencë mes universiteteve plotësisht autonome 36
Përvojë për krahasim 36
Masat e propozuara 37
Përfitimet 38

Propozimi 7: Futja e hulumtimit si kategori për financim në universitet 39
Përvojë për krahasim 39
Masat e propozuara 41
Përfitimet 41

Propozimi 8: Të lidhen fondet për hulumtime me nevojat e tregut 42
Përvojë për krahasim 43
Masat e propozuara 44
Përfitimet 45

Propozimi 9: Të prezentohen stimuj për funksionimin e bordeve industriale 46
Përvojë për krahasim 47
Masat e propozuara 47
Përfitimet 48

Propozimi 10: Të lidhet paga me performancë 49
Përvojë për krahasim 49
Masat e propozuara 50
Përfitimet 51

Propozimi 11: Kontrolli dhe balancimi 52
Masat e propozuara 53
Përfitimet 54

Përfundime 55

LISTA E PUBLIKIMEVE: 64

Përmbledhje ekzekutive

Me gjithë pajtimin e përgjithshëm se ajo që aktualisht ofrohet në arsim të lartë në Kosovë është nën standarde, personat përgjegjës për sistemin e arsimit tregojnë rezistencë të madhe ndaj ndryshimit. Çekuilibri kryesor vjen për shkakun se Universiteti i Prishtinës (UP) nuk u jep llogari klientëve që u shërben, qoftë drejtpërsëdrejti qoftë tërthorazi. Përgjegjësit për arsimin e lartë nuk kanë nxitje të duhura për të nxjerrë shërbime të cilësisë së lartë. Si pasojë, Kosova nuk është duke e shfrytëzuar në tërësi potencialin e kapitalit të saj njerëzor. Kjo, nga ana tjetër, për Kosovën paraqet një pengesë të vështirë në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Shumica e të diplomuarve universitarë në Kosovë nuk përputhen me nevojat aktuale të tregut të punës, lëre më me nevojat e ardhshme të këtij tregu. Me pak përqendrim në zhvillim të aftësive, pjesa më e madhe e fuqisë punëtore të Kosovës do të bëhet tepricë. Për më keq, një numër i vogël i përgjegjësve nga i tërë zinxhiri i qeverisjes (deputetët, qeveritarët, drejtuesit e universitetit, profesorët, studentët apo prindërit) shfaqin ndërgjegjësim për gjendjen e rënduar.

Ky hulumtim ofron një numër propozimesh të cilat, nëse do të miratoheshin, do ta bënin arsimin e lartë në Kosovë më konkurrues dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave të tregut të punës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Zyrës së Kryeministrit (SKZH) për 2016-2021, e publikuar në janar 2016, shërben si burim kryesor për propozimet e shtjelluara më poshtë. SKZH shënon zhvillimin e kapitalit njerëzor të Kosovës si shtyllë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Sikur SKZH-ja, edhe ky hulumtim synon ta përmirësojë kapacitetin e kapitalit njerëzor në vend, duke i zhvilluar më mirë aftësitë dhe duke e rritur llogaridhënien në arsimin e lartë.[1] Përveç kësaj, fondet e qeverisë për arsim duhen

përshtatur ashtu që universitetet të nxiten që të nxjerrin kërkime shkencore dhe përgjithësisht të tregojnë punë të mirë. Këto sugjerime do ta përmirësonin cilësinë e rezultateve të universiteteve. Për të qenë ndryshimi efektiv, duhet të jetë i vetështytur nga ata që mëtojnë ta përmirësojnë pozitën brenda sistemit. Çdo aktor në zinxhirin e qeverisjes duhet ta shohë përmirësimin e sistemit të arsimit të lartë si përgjegjësi personale.

Në këtë hulumtim janë identifikuar nevojat e sistemit të arsimit të lartë dhe janë sugjeruar rregullimet e mundshme në tri nivele: (a) përmirësime në legjislacionin primar (ligji për arsimin e lartë), (b) përmirësime në legjislacionit sekondar (statutet e universiteteve, rregulloret e ministrisë), ose (c) përmirësime në nivelin e politikave (mekanizmat e financimit).

Ligji për arsimin e lartë duhet t'i diktojë vetëm rregullat themelore, duke lejuar më shumë fleksibilitet për inovacion politikash në universitete. Veç kësaj, ligji duhet t'u japë autonomi institucioneve të arsimit të lartë për vendosjen e tarifave të shkollimit, në mënyrë që të nxitet një konkurrencë më e madhe midis shkollave. Gjithashtu, tarifat e shkollimit duhet të subvencionohen për studentët që tregojnë rezultatet më të mira, si dhe ata që nuk janë në gjendje ta paguajnë tarifën. Modeli i financimit për këto institucione duhet rishikuar për t'u përqendruar në rezultate, sipas nevojave të tregut. Për këtë qëllim, qeveria duhet t'i zbatojë metodat e përcjelljes së performancës së institucioneve. Mund të përdoren matje të treguesve të caktuar, siç është punësimi i studentëve pas diplomimit, për të kërkuar llogari nga qeverisja e arsimit të lartë. Në këtë vazhdë, strukturat e pagesës për personelin universitar duhen rishikuar për ta pasqyruar më mirë cilësinë e performancës së çdo mësimdhënësi. Qeveria duhet të aplikojë edhe fonde specifike kërkimore për universitetet. Ky financim duhet të zhvillohet ashtu që t'i nxitë

institucionet që të kryejnë kërkime në përputhje me nevojat e tregut. Universitetet duhet t'i shfrytëzojnë më shumë bordet industriale në mësimdhënie për studentët dhe për t'i ndihmuar ata të gjejnë punë pas diplomimit. Së fundi, duhet aplikuar kontrolle reciproke për t'i luftuar mosefikasitetet dhe konfliktet e interesit brenda strukturës qeverisëse të arsimit të lartë.

Hyrje

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë skemën aktuale të masave stimuluese në arsimin e lartë, të identifikojë pengesat dhe të ofrojë rekomandime. Skema e masave stimuluese në arsimin e lartë duhet të arsyetojë për të gjitha palët e interesuara që të nxjerrin aftësi gjithnjë më të mira, që kërkohen në tregun e sotëm dhe në të ardhmen e parashikueshme. Propozimet e radhitura më poshtë sugjerojnë ndryshime në projekt-ligjin aktual për Arsimin e Lartë, si dhe në aktet nënligjore dytësore dhe të tjera, me qëllim të aplikimit të stimujve efikas të performancës në tërë zinxhirin e qeverisjes. Siç u tha më lart, ky hulumtim dhe propozimet e përfshira në të janë në përputhje me qëllimet e Shtyllës 1 të SKZH-së 2016-2021.

Përkundër pajtimit të përgjithshëm se sistemi universitar në Kosovë është në nivel të pakënaqshëm, gjasat për ndryshim janë të vogla. Ka rezistencë të madhe kundër reformës, gjersa janë shprehur shqetësime të pakta nga qytetarët apo deputetët që i përfaqësojnë. Sistemi i stimulimeve, i krijuar ndër vite, e ka bërë të pamundur realizimin e ndryshimit përmes një procesi nga poshtë-lart. Madje, edhe përpjekjet e Rektorit të mëparshëm të UP-së për ta ngritur standardin e arsimit ishin të pasuksesshme për të grumbulluar përkrahje të mjaftueshme nga radhët e stafit mësimdhënës.

Nuk ka asnjë sistem që kërkon llogari nga UP karshi studentëve dhe prindërve të tyre. Strukturat drejtuese të universiteteve publike janë zgjedhur nga profesorët, sikur universiteti të ishte kompani private, ku stafi mësimor është aksionari i vetëm. Nëse një dekan do të kërkonte nga profesorët që të tregojnë punë më cilësore – të nxjerrin programe të reja mësimore, të ofrojnë rezultate ambicioze të të nxënit që kërkohen nga tregu i punës, t'i ripërtërijnë librat e tyre krahas zhvillimeve, të organizojnë simulime në klasë, të kërkojnë nga studentët më shumë punime të

shkruara, të japin informata të personalizuara kthyese, etj. – ai/ajo dekan/e me shumë gjasë nuk do të rizgjidhej.

Në disa mënyra, universitetet janë institucionet e fundit që të kujtojnë vetëqeverisjen e viteve të tetëdhjeta. Ky s'do të ishte problem i madh, po të mos ishte fakti se pjesa dërrmuese e buxhetit për universitetet publike vjen nga xhepi i qytetarëve, qoftë në formë të granteve të përgjithshme fikse, qoftë nëpërmjet pagesave të tarifave të studentëve.

Pyetja e hulumtimit tonë na bën t'i mendojmë mënyrat për ta shkundur sistemin e për ta bërë atë më konkurrues dhe më të përgjegjshëm, ashtu që kërkesa për ndryshim të nxitet nga brenda. Ky ndryshim sistematik duhet të vijë nëpërmjet interesit vetjak të aktorëve individualë. Ndonëse e vështirë të imagjinohet tani për tani, që ndryshimi të jetë efektiv, ai duhet të vetështytet dhe të ushqehet përherë nga ata që synojnë ta përmirësojnë pozitën vetjake – dhe në këtë mënyrë, ta përmirësojnë sistemin.

Të gjitha palët janë aktorë racionalë. Në mënyrë që interesin e tyre profesional ta lidhin me atë publik, rregullat duhet ta bëjnë atë të arsyeshëm për të gjithë vendimmarrësit, menaxherët dhe administratorët, që t'u përgjigjen nevojave të tregut, si pjesë e mënyrës se si e kuptojnë interesin vetjak. Kjo mund të bëhet duke punuar së pari nga lart-poshtë me ligjvënësit në Parlament, zyrtarët në Qeveri dhe me shoqërinë civile, duke e shtuar kështu kërkesën për performancë dhe rezultate të larta nga ofruesit e arsimit të lartë (poshtë-lart). Këto rregulla të reja duhet t'i shpërblejnë profesorët më efektivë e më të vyeshëm dhe t'i mënjanojnë rregullat e votimit që e lejojnë një shumicë profesorësh, të organizuar në baza klanesh të ndryshme, ta drejtojnë universitetin si t'u përshtatet interesave të tyre të ngushta.

Ky hulumtim është organizuar në këtë renditje: pjesa e radhës përvijon metodologjinë e përdorur dhe përshkruan

audiencën e synuar të hulumtimit. Pjesa vijuese përvijon sistemin aktual të stimulimeve në arsimin e lartë, duke u përqendruar në secilin nga aktorët që marrin pjesë në sistem (pra: profesorët, rektorin, anëtarët e bordit). Pjesa e radhës paraqet situatën aktuale në shifra, duke u përqendruar në perceptimet e përgjithshme publike, si dhe në të dhënat nga studime të ndryshme. Pasohet seksioni nga 11 propozime për trajtimin e frenuesve që aktualisht veprojnë në ekosistemin e arsimit të lartë.

Metodologjia dhe audienca

Hulumtimi për këtë punim filloi me një kërkim të gjerë të praktikave më të mira që lidhen me modalitetet e financimit, llogaridhënies dhe qeverisjes në arsimin e lartë. Praktikat ndërkombëtare mandej u krahasuan me kornizën ligjore të Kosovës, projekt-legjislacionin dhe praktikat më të përhapura. Kjo u mundësoi autorëve ta vendosin Kosovën në paradigmat kryesore të arsimit të lartë. Një qasje e tillë mundësoi zgjerimin e alternativave të politikave të disponueshme për t'ua propozuar politikëbërësve për shqyrtim.

Ky dokument synon të kapë audiencë të gjerë, por më specifikisht shënjestron politikëbërësit përgjegjës për sektorin (përfshirë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), si dhe të gjithë deputetët e zgjedhur, sidomos ata të Komisionit për Arsim. Hulumtimi më tej i synon administratorët e universiteteve, dekanët dhe profesorët, si dhe shoqërinë civile e mediat. Për ndikim më afatgjatë, ky hulumtim arrin tek nxënësit dhe prindërit, duke synuar të ngjallë ndër ta ndjenjën se janë klientët kryesorë të shërbimeve të arsimit të lartë dhe, si taksapagues, financuesit kryesorë të sistemit të arsimit publik.

Qeverisja e dekurajuar e arsimit të lartë

Legjislacioni aktual mban një sistem qeverisjeje të arsimit të lartë me një grup stimujsh e dekurajimesh të synuara e të pasynuara për palët, në gjithë zinxhirin e menaxhimit. Ky seksion përshkruan shkurtimisht aktorët kryesorë dhe stimuj/pengesa.

Kuvendi

Si më i larti organ legjislativ në vend, Kuvendi zgjedh Qeverinë, nga e cila kërkon llogaridhënie përmes komisioneve funksionale dhe diskutimeve plenare. Kuvendi themeloi Universitetin e Prishtinës dhe është i vetmi autoritet që mund t'ia ndryshojë statutin. Megjithatë, kështu nuk është për universitetet e tjera publike, pasi ato qenë themeluar në bazë të vendimeve të Qeverisë.[2]

Komisioni Parlamentar për Arsim e Shkencë monitoron zbatimin e legjislacionit nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), si dhe nga vetë universitetet. Ky komision rishikon politikën qeveritare dhe e ndryshon, për të kërkuar konsensus të mjaftueshëm me partitë e tjera dhe grupet e interesit. Komisioni, përveçse rekomandon përmirësime, ka fuqinë të kërkojë llogaridhënie nga ministri dhe aktorë të tjerë në menaxhimin e arsimit të lartë. Megjithatë, disa nga anëtarët e komisionit parlamentar janë profesorë vetë[3] dhe prandaj aspak të inkurajuar që të fusin standarde më kërkuese në arsimin e lartë.

Qeveria

Në nivelin politik, stimujt për ndryshim të qeverisë rëndom lidhen me shanse më të mira për rizgjedhje. Një ministër që dëshiron të rizgjidhet, ose partia e të cilit dëshiron të perceptohet sikur ka dhënë rezultate të mira në arsim, duhet

të tregojë interes për ofrimin faktik të rezultateve pozitive. Zyrtarët kanë interesa të tjerë konkurruese, si: (a) rreziku i dështimit, (b) dëshira për t'i shmangë skandalet, (c) dëshirë për t'i mbajtur ulët protestat, (d) bilanci i interesave të anëtarëve të partisë që punojnë për universitetin, ose (e) mungesa e sigurisë lidhur me plane të veçanta - të gjitha arsye që zvogëlojnë entuziazmin për reformë.

Sikurse deputetët, shumë ministra të arsimit janë edhe profesorë. Për shembull, në qeverinë aktuale, kryeministri dhe shtatë ministra japin mësim në Universitetin e Prishtinës.[4] Titulli profesor i një ministri ka gjasë të zgjasë më shumë se mandati i tij si ministër. Si i tillë, është e sigurt të parashikohet se dikujt vizioni i karrierës afatgjatë i konkurron me interesin për të kontribuar në sistem arsimor të përgjegjshëm.

Bordi i Universitetit

Bordi në Universitetin e Prishtinës emërohet pjesërisht nga Ministri (4 anëtarë) dhe pjesërisht zgjidhet nga Senati i Universitetit (5 anëtarë)[5]. Në universitetet e sapokrijuara, bordet emërohen plotësisht nga ministri, pasi këto institucione ende po punojnë për miratimin e statuteve dhe zgjedhjen e senateve. Anëtarët e Bordit u nënshtrohen disa stimujve ose presioneve për të siguruar performancën më të mirë për interesin publik. [6] Pa stimuj efektiv për ta promovuar performancën, anëtarët e bordit pëlqejnë ta ruajnë *status quo*-në. Në mënyrë që bordet e universitetit ta përmirësojnë performancën vetjake dhe të kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në institucionet publike, sistemi i stimujve duhet të ndryshojë.

Rektori

Dy rektorë në UP dhanë dorëheqje në tri vitet e fundit. I pari dha dorëheqje në mes të një skandali mbi publikimet në një revistë të rreme, që qenë përdorë për të avancuar pozitën e

tij akademike. Duhet vënë re se dorëheqja e parë nuk u zbulua nga mekanizmat e brendshëm të kontrollit të cilësisë. Ai u detyrua të jep dorëheqje vetëm kur protestat popullore u shtuan në numër dhe zgjatën disa javë. Rektori i dytë dhe dorëheqje meqë përballej me një shumicë profesorësh të bashkuar në rezistencën e tyre ndaj standardeve më rigoroze për promovimin akademik (ende i ulët sipas standardeve ndërkombëtare).

Të dy shembujt tregojnë se stimujt e brendshëm nxisin përdorimin e çdo mjeti për vetëpromovim akademik, dhe e dekurajojnë shumë ndryshimin drejt llogaridhënies më të lartë, por edhe kontrollit të cilësisë së performancës akademike. Për më tej, mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies i bëjnë dekanët të përgjegjshëm përpara kolegëve të tyre në Senat, më parë sesa para rektorit. Senati shpeshherë shpërfill standardet dhe merr vendime me votim. Kësisoj, sundimi i shumicës i ka ulur më tej standardet akademike.

Dekanët

Një strukturë e ngjashme stimujsh e dekurajimesh vlen edhe për pjesën tjetër të qeverisjes dhe të zinxhirit të administratës. Dekanët zgjidhen nga personeli akademik në fakultete, ndaj struktura e stimulimit vepron kundrejt stafit para se kundrejt industrisë, studentëve a rektorit. Nëse një përfaqësues kompanie i thotë një dekani se të diplomuarit nuk i kanë aftësitë e nevojshme për tregun e punës, dekani ka opsione të kufizuara dhe pakëz motivim për ta korrigjuar situatën. Dekanit mund t'i duhet (a) ta ndërrojë stafin (nga të cilët i varet rizgjedhja), ose (b) t'i kërkojë stafit të nxjerrë kurrikula të reja, kur dihet se kjo vështirë bëhet. Dekani nuk merr asnjë shpërblim nëse përpiqet të nxjerrë sa më shumë të diplomuar të punësuar me aftësi të tregtueshme, e nga ana tjetër, gjasat për t'u rizgjedhë mund t'i reduktohen.

Ndikimi i bordeve industriale mbi stimujt vështirë të

vlerësohet, meqë bordet e tilla janë ngritë veç në këto kohët e fundit. Megjithatë, ka mundësi të vlerësohet ndikimi i kërkesave nga sektori privat. Për ca kohë, punëdhënësit e mëdhenj në Kosovë thoshin se studentëve të diplomuar nga universitetet publike u mungojnë aftësitë e transferueshme (si të shkruarit, prezentimi ose të menduarit kritik). Kjo u pranua edhe nga MAShT,[7] porse pak nisma u ndërmorrën për rishikime kurrikulash.

Profesorët

Profesorët kanë pak stimuj për t'iu përqendruar cilësisë, sepse puna e vyeshme nuk do përkthehet doemos në pagë më të mirë a promovim. Një profesor që plagjiarizon punimet mund të publikojë numër më të madh punimesh kundrejt një profesori të ndershëm e punëtor. Kështu, profesori i parë mund të promovohet më parë se i dyti. Rasti i ish-rektorit është tejet ilustrativ. Ai u detyrua të jep dorëheqje si rektor, por ironikisht u lejua ta vazhdonte punën si profesor, pavarësisht se punimet i botonte në revista të rreme. Më së voni pati raste doktoratash plagjiate[8] dhe mëtesash për plagjiaturë nga kolegët e dekanëve të sapoemëruar në disa fakultete.[9]

Njëherësh, paga e profesorëve lidhet me ngarkesën e punës mësimdhënëse e jo me rezultatet e hulumtimit. Shembulli më i keq i kësaj praktike është fakti se profesorët paguhen sa herë ndonjë student hyn në provim përfundimtar, çka i nxit profesorët t'i ngelin studentët për t'i rritur të ardhurat vetjake. Profesorët paguhen edhe për çdo tezë që mbrohet para tyre, pa kufizim të numrit të studentëve që mund të mbikëqyrin. Sa kohë profesori është i pranishëm në klasë, mban provimet dhe publikon notat, nuk ka siguri cilësie të mëtejme të përcaktuar. Nuk është çudi që shumica e profesorëve në Senat qenë kundër rektorit reformist. Shumë u ankuan, kërkuan t'i shtynin standardet më rigoroze për ndonjë të ardhme më të largët.

Gjendja e tashme në shifra



Fig. 1 Kategorizimi i profileve dhe shkathtësive të vendeve të punës është realizuar përmes kategorive të shkathtësive të Eurostat. Te dhënat fillestare të orientimit të studentëve të arsimit të lartë në raport me fushat e shkathësive, për të cilat janë krijuar vende punë në tërësi në Kosovë ndërmjet 2003-2013 (ASK, 2014),tregojnë një shpërputhje të theksuar [10]

Sistemi i stimujve të gabueshëm ka sjellë situatën aktuale, në të cilën arsimi i lartë nxjerr kuadro me diploma, por pa aftësitë e nevojshme që kërkon tregu. Tregu i punës në Kosovë përballet me probleme të shumanshme strukturore, të lidhura me masën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët, dhe trendi i punësimit që gjenerohet viteve të fundit nuk garanton

punësimin e të diplomuarve. Siç tregon figura më poshtë, studentët në Kosovë priren të përqendrohen në fusha që janë në shpërpjesëtim me trendet që gjenerojnë vende pune.

Publiku në Kosovë ka larg më shumë besim në aftësinë e universiteteve për të prodhuar të diplomuar të tregtueshëm sesa mund të sugjerojnë shifrat në grafikun e mësipërm. Në një sondazh të kryer nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), të anketuarve iu kërkua të pajtoheshin ose jo me deklaratën se "Universiteti i Prishtinës prodhon të diplomuar që përmbushin kërkesat e tregut të punës në Kosovë." Më se 44% e të anketuarve pajtohen deri diku me këtë pohim. Sipas grupmoshave, veç grupit më të ri (18-24 vjeç), shumica e anëtarëve të grupmoshave të tjera besojnë se UP u ofron studentëve aftësi të mjaftueshme për tregun e punës.

Përgjigjet ndryshuan kur të anketuarve iu kërkua t'i vlerësonin aftësitë vetjake në përballje me tregun e punës. Kur iu kërkua të pajtoheshin ose jo me deklaratën "Niveli i njohurive dhe aftësive që kam është në përputhje me kërkesat e tregut të punës," nga të anketuarit, 16.2% u pajtuan plotësisht, dhe më se 60% i panë aftësitë e veta si të favorshme në lidhje me tregun e punës. Ndarë sipas grupmoshave, shumica e të anketuarve të rinj që sapo futen në fuqinë punëtore (18-24 vjeç) nuk janë krejt të sigurtë në aftësinë për të konkurruar në treg, e vetëm 15.9% janë të sigurtë në aftësitë dhe njohuritë vetjake.

Të pyetur se ç'mund të bëhet për t'i adresuar mangësitë në arsimin universitar, një shumicë e të anketuarve mendonte se përfshirja e punës praktike si pjesë e procesit të të nxënit do t'u përmirësonte aftësitë (21.2%). Përgjigjet e tjera të shpeshta sugjeronin përmirësimin e cilësisë së mësuesve (16.3%) dhe përshtatjen e programit mësimor me kërkesat e tregut (15.1%). Duke pasur këtë në mendje, seksionet e mëtutjeshme përvijojnë një numër propozimesh që synohen për trajtimin e disa dekurajimeve në sistemin e arsimit të lartë.

Propozimi 1: Plotësimi i konkurrencës me më shumë hapësirë për politikëbërje

Projektligji aktual synon që tërë arsimin e lartë ta rregullojë me ligj, duke e bërë kështu të vështirë ndryshimin e rregullativës. Kjo shtytje deri diku është e kuptueshme, për shkak të zhvillimeve të fundit negative në Universitetin e Prishtinës dhe në arsimin e lartë përgjithësisht. Megjithatë, praktika e mirë legjislative duhet t'u lejojë më shumë hapësirë politikave për vendimmarrje. Nëse secili përmirësim kërkon ndryshim ligji, përmirësimi bëhet i vështirë dhe reformatorët dekurajohen. Legjislacioni deri këtu nuk ka qenë në gjendje t'i ndreqë trendet negative në arsimin e lartë dhe stërregullimi dekurajon kreativitetin në të çdo nivel burokracie. Ky përqendrim mbi rregulloren mund të kishte dhënë fryte për të siguruar një minimum të nevojshëm sikur Ministria e Arsimit t'i zhvillonte disa piketa konkrete dhe masa zbatuese në rast se ofrimi i shërbimeve bie poshtë synimeve të përcaktuara.

Një rast tipik kur rregullorja parandalon politikëbërjen inovative lidhet me titujt akademikë dhe punësimin e personelit mësimdhënës. Projektligji aktual parasheh që në procesin e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Kosovë, janë në dispozicion këta tituj akademikë:

> Institucioni publik i arsimit të lartë për personelin akademik mund të caktojë titujt akademikë si vijon: Profesor i rregullt (Profesor); Profesor i asociuar; Profesor asistent; Asistent[.][11]

Projektligji aktual përjashton postin e Ligjëruesit, një pozitë që u mundëson institucioneve të angazhojnë profesionistë me përvojë nga fushat përkatëse, duke shtuar vlerë të madhe në ligjërim të fushave të aplikuara (menaxhim, administratë publike, ndërmarrësi, etj.), sidomos në nivelin themelor të studimeve (bachelor). Të tilla formulime të

detajuara pa nevojë mund të gjenden në rastin e titujve akademikë dhe në dhënien e tyre:

> Për titullin e Profesorit të asociuar, kandidati duhet t'i ketë botuar tri (3) publikime në nivel ndërkombëtar. Publikimet e nivelit ndërkombëtar nënkuptojnë një artikull shkencor të publikuar në ndonjë revistë ndërkombëtare, të indeksuar në Web of Science, në Scopus, ose platforma shkencore të njohura në nivel ndërkombëtar, me një "Faktor ndikimi" >0, ose në revista që merren me tema ekonomike, sociale e kulturore me vlerë për Kosovën që në pikëpamjen e ekspertëve të fushës përkatëse konsiderohen të cilësive të krahasueshme.[12]

Ky përqendrim në tituj dhe rregulla të rrepta për angazhim personeli siguron një standard minimal, por edhe krijon dekurajime për cilësinë e performancën. Ndërsa projektligji duket sikur përpiqet të përmbushë një standard minimal, ai lejon edhe interpretime gjithëfarë, që lehtësisht çojnë në epje të mundshme rregullash në praktikë.

Për më tej, ky stërregullim çon në shpërputhje mes ligjit e praktikës. Nëse projekt-ligji aktual miratohet në trajtën e tashme, shumë institucione të arsimit të lartë do të detyroheshin me u mbyllë. Nëse e kaluara është ndonjë tregues, në të vërtetë, institucionet mund të funksionojnë duke qenë në kundërshtim me ligjin.

Përvojë për krahasim

Lidhur me shembullin e titujve akademikë të nevojshëm për mësimdhënie, hulumtimet mbi praktikat botërore tregojnë se edhe institucionet që prijnë, ofrojnë më shumë fleksibilitet në punësimin e personelit mësimdhënës sesa universitetet e Kosovës. Një shembull i dukshëm vjen nga Massachusetts Institute of Technology (MIT). Joi Ito, njeri vetëm me diplomë shkolle të mesme, drejton laboratorin më

të njohur të medias në botë, MIT Media Lab. Ito së fundmi është bërë edhe profesor.[13] Qasje të ngjashme mund të gjenden në shumë shkolla teknologjie, biznesi, diplomacie dhe fushash të tjera, ku përvoja vlerësohet më lart se arritja e titujve akademikë.[14]

Masat e propozuara

Ligji duhet të përcaktojë drejtimet kryesore dhe parimet themelore, ndërsa të lejojë që specifikat të zhvillohen nga Ministria ose Bordet/Senatet e institucioneve të arsimit të lartë. Kjo do të mundësonte jetëgjatësi të ligjeve të miratuara dhe në të njëjtën kohë do të krijonte hapësirë të mjaftueshme politike që vendimmarrësit të çojnë para nisma të reja, pa kaluar nëpër procesin e lodhshëm të ligjbërjes. Gjithashtu, kjo do t'ua lironte kohën ligjbërësve, duke u mundësuar të përqendrohen në vlerësim dhe matje të performancës.

Qasje e ngjashme do të mund të ndiqej në raport me botimet shkencore. Në vend të përcaktimit të rregullave me ligj, ligji do të mund t'i obligonte të gjitha katedrat akademike që të miratojnë një listë revistash që konsiderohen të denja për botim në secilën fushë. Këto lista do të duhej të bëheshin publike dhe të miratoheshin nga senati. Kjo metodë do të shmangte situatat e interpretimit të dyshimtë të dispozitave " ose në revistat që trajtojnë tema ekonomike, shoqërore dhe kulturore me interes për Kosovën e të cilat prej ekspertëve të fushës konsiderohen si të krahasueshme për nga cilësia ". Në aspektin afatshkurtër, kjo mund të çojë në publikime të cilësisë më të ulët. Sidoqoftë, cilësia e publikimeve do të rritej nëse kriter për ndarje të buxhetit dhe promovim të tyre do të bëhej cilësia e tyre. Kjo do t'i nxiste institucionet që ta rrisin kriterin për publikime akademike, si dhe cilësinë e produktit të tyre.

Përfitimet

I tërë sistemi do të përfitonte nga rregullativa më pak strikte. Lejimi i universiteteve për t'u dalluar me legjislacion sekondar, do t'i nxiste ato për të krijuar rezultate më të mira, në mënyrë që të tërheqin studentë më të mirë. Kjo pastaj do ta rriste cilësinë e rezultateve të shkollave. Deputetët do të përfitojnë ngase do të duhet të hartojnë ligje më pak të detajuara, duke përfituar më shumë kohë për t'i matur treguesit e performancës së universiteteve. Nga kjo më tutje do të përfitojë i tërë sistemi, duke e kërkuar llogari nga çdo aktor për pjesën e tij të punës. Përveç kësaj, duke qenë se ligjet më pak strikte zakonisht zbatohen për periudha më të gjata kohore sesa ato strikte, çdo person i përfshirë në sistem do të përfitojë duke qenë në gjendje ta planifikojë sjelljen e vet shumë kohë përpara.

Propozimi 2: Modele dinamike financimi të bazuara në performancë

Institucionet publike të arsimit të lartë mbeten të varura në masë të madhe nga financimi që u vjen për funksionim nga qeveria. Modalitetet e financimit mbeten mjetet më të mira për të zhvilluar stimuj që ta rrisin cilësinë dhe llogaridhënien e institucioneve të arsimit të lartë.

Sikurse ky projektligj, ligji aktual ka një model statik të financimit për IAL-të, që shpie në motivim të ulët. Siç tregon formulimi i mëposhtëm, formula buxhetore bazohet në numrin e studentëve të regjistruar dhe nuk merr parasysh asnjë faktor që lidhet me cilësinë ose performancën:

> Ndarja e fondeve për mësimdhënie specifikon numrin e studentëve të institucioneve publike të arsimit të lartë që të arsimohen me shpenzime publike në disa disiplina a fusha studimi. Ky numër duhet të jetë në përputhje me numrin maksimal që përcaktohet në licencën aktuale të institucionit.[15]

Për më tej, megjithëse ligji aktual dhe projektligji ofrojnë mundësi (shih më poshtë) për një vendimmarrje inovative, deri më tash kjo nuk ka ndodhur në praktikë.

> Në bashkëpunim me Ministrin e Financave dhe institucionet publike të arsimit të lartë, Ministri i propozon Qeverisë një akt nënligjor që përcakton metodologjinë e në përdorim për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes publik, së bashku me shtesat ose koncesionet e tjera.[16]

Në kohën e këtij shkrimi, nuk janë hartuar akte nënligjore që të sigurojnë qartësi të mëtejme në metodologjinë e përdorur për financimin e kërkimit shkencor.

Përvojë për krahasim

Ka një trend global që lëviz nga modelet statike të financimit të arsimit të lartë drejt futjes së financimit të orientuar kah prodhimi. Gjithnjë e më shumë vende po i përdorin treguesit e performancës të studentëve për të përcaktuar madhësinë e granteve të financimit të dhëna për secilin institucion. Disa vende (p.sh. Danimarka, Austria dhe Lihtenshtajni) marrin parasysh numrin e studentëve që kanë kaluar provimet, ndërsa të tjerat (p.sh. Suedia dhe Norvegji) marrin numrin e krediteve të fituara nga studentët. Ka edhe një dallim mes vendeve se si matin numrin e studentëve për formula financimi. Mbretëria e Bashkuar nuk e merr numrin e studentëve të regjistruar, por atë të studentëve që mbarojnë vitin e studimit. Zyrtarët në Holandë matin shkallën e ngeljes të studentëve në fund të vitit të parë. Në Itali, numri i studentëve që braktisin shkollën dhe studimet është ai që merret parasysh.[17]

Modele financimi të bazuara në kriterin e studentëve				
	Danimarka	MB	Italia	Kosova
Suksesi i studentëve në provim	X			
Përfundimi i studimeve		X		
Shkalla e kalimeve/ngeljeve	X		X	
Numri i studentëve të regjistruar				X

Masat e propozuara

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë shumëllojshmëri të modeleve aktuale të financimit. Financimi duhet të përcaktohet nga një formulë financimi e bazuar në rezultate dhe ndikime që lidhen me numrin e studentëve të diplomuar në fusha të veçanta, ndërlidhur këto me nevojat e tregut. Për këtë, ose MAShT-i ose Komisioni i Parlamentit për Arsim duhet ta rishikojë nenin 39 të Ligjit. Më

konkretisht, Paragrafi 3 mund të formulohet si vijon:

> Në bashkëpunim me Ministrin e Financave dhe institucionet publike të arsimit të lartë, ministri ia propozon rregulloren/ udhëzimin administrativ Qeverisë ku përcakton rezultatet e pritura dhe indikatorët e performancës që përdoren për llogaritjen e fondeve që caktohen për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes publik, bashkë me shtesa të tjera ose koncesione.

Paragrafi 4 mund të formulohet kësisoj:

> Ndarja e fondeve për mësimdhënie përcakton numrin e studentëve të institucioneve publike të arsimit të lartë që do të arsimohen me shpenzime publike në disa disiplina a fusha studimi. Ky numër duhet të përputhet me numrin maksimal që përcaktohet në licencën aktuale të institucionit. Kjo ndarje fondesh duhet të përputhet me rezultatet e pritura të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar nga qeveria që adreson rezultatet e pritura dhe indikatorët e performancës të përvijuar për periudhën e financimit.

Formulat e financimit duhet të përdorin si kriter fushat kyçe për nevoja ekonomike, performancë, nivel arsimor, si dhe shkathtësi që mund të vihen në punë.

Përfitimet

Standardet e performancës dhe ato të bazuara në treg për financimin publik të institucioneve do t'a rrisin shumë efikasitetin e IAL-ve. Duke i nxitur shkollat ta orientojnë rezultatin dhe studentët drejt fushave ku tregu është i mangët, edhe sistemi universitar edhe ekonomia në tërësi do përfitojnë. Veç kësaj, studentët do përfitojnë vetë, sepse do diplomohen me aftësi të projektuara posaçërisht për t'i bërë të punësueshëm në tregun e punës.

Propozimi 3: Përcjellja e performancës

Përcjellja e performancës duhet së pari të futet në të gjithë sektorin arsimor e pastaj në të gjithë administratën publike. Përcjellja më e mirë e rezultateve dhe menaxhimit të performancës në vende të tjera ka çuar në rezultate më të mira nga institucionet e arsimit të lartë. Përcjellja e performancës mundëson formula buxhetore të bazuara në shkathtësi punësimi, çka lidh performancën me pagat. Rrjedhimisht, kjo mundëson renditjen e universiteteve dhe të departamenteve, më e rëndësishmja, kthen nxënësit dhe prindërit në klientë të vërtetë, që mund të bëjnë zgjedhje të informuara.

Projektligji aktual ka gjuhë identike si ligji në fuqi, në mënyrën si mundëson kontrata performancë ndërmjet MAShT-it dhe IAL-ve.

> Për çdo vit akademik, institucionet publike të arsimit të lartë ia paraqesin raportet vjetore Ministrit mbi aktivitetet e kryera, performancën vjetore, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik dhe elemente të tjera të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit. Ky raport duhet dorëzuar jo më vonë se më 31 mars të vitit vijues.[18]

Për më shumë, ligji përcakton:

> Raporti i performancës do të krahasojë rezultatet e arritura me planin e zhvillimit strategjik dhe marrëveshjen e performancës për vitin në shqyrtim.[19]

Gjuha e mësipërme lejon, por nuk detyron, rangimin a gjurmimin e performancës. Deri më sot këto praktika të përcaktuara me ligj nuk janë zbatuar a diskutuar; krahas kësaj, nuk janë rishikuar marrëveshjet e financimit ndërmjet qeverisë dhe institucioneve publike të arsimit të lartë. Tani që Kosova ka gjithë ato universitete publike,

krahasimi në gjithë sektorin publik është i mundshëm.

Përvojë për krahasim

Një numër në rritje shtetesh po lëvizin drejt dhënies së fondeve të drejtpërdrejta publike në përputhje me kontratat e veçanta të performancës të lidhura mes qeverive dhe institucioneve të arsimit të lartë. Këto kontrata vendosin ndarjen e buxhetit për një institucion të dhënë duke përcaktuar objektivat e përgjithshëm strategjikë për institucionin. Në disa raste, këto kontrata përdoren për të matur suksesin e institucioneve në arritjen e objektivave të veta. Kështu, këto kontrata të performancës janë mekanizëm i rëndësishëm që u mundëson IAL-ve publike t'i udhëheqin politikat institucionale strategjike. [20] Për më shumë, kontratat e tilla përmbajnë formulim të veçantë që lidh performancën me ndarjen e buxhetit.

Mënyrat e financimit publik					
	DK*	Franca	Austria	RU**	Kosova
Kontratat e performancës	X	X	X	X	X***
Objektivat specifik	X	X	X	X	
Objektivat e përgjithshëm					X***

* Danimarka, ** Rumania

*** Dispozitat në ligj, në praktikë nuk zbatohet.

Praktikat më të mira evropiane që lidhen me kontratat e performancës janë përmbledhë në një raport të përgatitur nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë për çështjen e Qeverisjes së arsimit të lartë në Evropë, botuar më 2008. [21] Tri forma kryesore të financimit janë identifikuar nga raporti.

Sipas praktikës së parë (p.sh. Danimarka e Austria), kontratat e performancës përgatiten asisoj që të hartojnë objektivat strategjikë të universiteteve, mjetet dhe fushat e

synuara. Këto kontrata përgjithësisht përqendrohen në aktivitetet kyçe si arsimi, hulumtimi, përhapja e njohurive dhe shkëmbimi i dijes. Objektivat mund të përfshijnë edhe qëllimet me të gjera si kontributi për progresin social (masat për ta rritur numrin e grave në pozita të larta, kurse për studentët që punojnë dhe kërkime në fushat me ndikim social).

Në grupin e dytë të shteteve (p.sh. Franca e Luksemburg),

> kontratat vendosin objektiva për universitetet dhe përfshijnë cilësinë e ofrimit dhe hulumtimin, qeverisjen, luftën kundër pabarazisë, etj. Ato duhet t'i artikulojnë kërkesat e shërbimit publik kombëtar në drejtim të arsimit të lartë, me politikat dhe opsionet strategjike për zhvillimin e institucioneve individuale.[22]

Sipas qasjes së tretë (p.sh. Rumania),

> plani strategjik, mbi të cilin bazohet kontrata, duhet të përfshijë objektivat strategjikë të çdo institucioni, programet e tij mësimore dhe strategjitë që do të miratohen për mësimdhënie, hulumtim, menaxhim burimesh njerëzore, partneritete, financim, strategji menaxheriale dhe strategji të sigurimit të cilësisë[23].

Të gjitha vendet e lartpërmendura zbatojnë një formë të kontratave të performancës në arsimin e lartë publik. I vetmi ndryshim qëndron në mënyrën se si caktohen objektivat, në kontrata dhe në planet themelore strategjike.

Masat e propozuara

Me ligjin e ri, Qeveria duhet të krijojë praktika për krijimin e kontratave të performancës ndërmjet Qeverisë dhe IAL-ve. Këto kontrata duhet të shërbejnë jo vetëm si mekanizma të llogaridhënies, por edhe të lidhen direkt me metodat e financimit. Këto kontrata të performancës duhet të shkojnë

përtej nivelit të Ministrit dhe të diskutohen në kuadër të Komisionit për Arsim në Kuvendin e Kosovës. Në këtë aspekt mund të shqyrtohet futja e një paragrafi në nenin 39 të Ligjit dhe të riformulohet Neni 44 paragrafi 3 për t'i përfshirë ndryshimet e bëra në Nenin 39.

Përfitimet

Zbatimi i kontratave të performancës për financim të IAL-ve, së bashku me ndryshimin e mekanizmave të financimit siç sugjerohet në Propozimin 3, do të shtonte përgjegjshmërinë mes stafit dhe qeverisjes së IAL-ve. Në qoftë se këto kontrata hartohen ashtu që të dalin direkt te nevojat e tregut, shkollat do të detyrohen ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies, e studentët me prindërit do përfitojnë. Duke fituar aftësi që i bëjnë të punësueshëm, studentët do merrnin kthim shumë më të mirë për investimet në tarifat e shkollimit se ç'marrin aktualisht.

Propozimi 4: Tarifat dhe financimet të lidhen me cilësinë e studentëve dhe mundësitë e tyre për të paguar

Të gjithë studentët në institucionet publike të arsimit të lartë trajtohen njëjtë si me pagesat për studime ashtu edhe mbështetjen e shtetit, d.m.th. paguajnë një tarifë nominale pavarësisht programit të studimit, suksesit në provim pranues ose gjatë studimeve. Po ashtu ata paguajnë të njëjtën tarifë për studime pavarësisht gjendjes së tyre financiare/ekonomike. Veç rreth dy për qind e studentëve më të mirë fitojnë një bursë në bazë të notave.

Si ligji aktual ashtu edhe projektligji e përcaktojnë njësoj vendosjen e tarifave:

> Ministri përcakton me akt nënligjor, që shqyrtohet çdo vit, pagesën maksimale për shkollim që të paguhet nga studentët e pranuar në një institucion publik të arsimit të lartë, të financuar nga Qeveria.[24]

Ligji lejon me vendosë nivele të ndryshme tarifash:

> Tarifat e shkollimit mund të vendosen në nivele të ndryshme, [varet] nëse nxënësi jeton në Kosovë ose tjetërkund [ose] për programe të ndryshme sipas [. . . kostove të programeve specifike].[25]

Pavarësisht nga kjo dispozitë, krejt studentët paguajnë të njëjtin çmim, pavarësisht nga meritat, programi që zgjodhën apo gjendja financiare që kanë. Tarifat dhe shpenzimet janë mjet i fortë për politikëvënie, e që duhet përdorë.

Përvojë për krahasim

Praktikisht s'ka shtete që t'i trajtojnë të gjithë studentët njëlloj kundrejt barrës financiare të këtyre. Gati të gjitha shtetet japin bursa të plota për të mirët dhe më të varfërit.

Meqë shumica e vendeve kanë lëvizë drejt financimit të objektivave specifikë që duhen arritur nga IAL-të, një numër indikatorësh janë lidhë me normat e suksesit të nxënësve. Për shembull, në ShBA, financimi ofrohet për studentë që diplomojnë brenda një numri të paracaktuar vitesh e që mbajnë një minimum note mesatare (NM).

Shumica e vendeve bëjnë dallimin e thjeshtë mes modeleve të financimit për programet bachelor dhe nivelet pasdiplomike të arsimit. Disa vende të BE-së po lëvizin drejt studimeve falas ose pothuajse falas të ciklit Bachelor për studentët më të mirë. Nivelet e mësipërme po shihen gjithnjë e më shumë si vlerë e shtuar për konkurrencë në treg; ndaj universitetet edhe marrin më shumë për këto programe. Programet PhD po lidhen gjithnjë më fort me projekte specifike kërkimore dhe financohen plotësisht nga institucionet shtetërore ose private.

Një qasje më të ndryshme ndjek ShBA-ja, ku kostoja nominalisht është e njëjtë për të gjithë, por studentët më të mirë marrin fonde të plota ose kredi nga shteti. Në nivele doktorature, financimi për studentët lidhet me mësimdhënien që u vihet dhe kryerjen e detyrave të tjera akademike gjatë kohës së studimit.

Diversifikimi i tarifave sipas studentëve			
	BE	ShBA	Kosova
Tarifa të ndryshme për kategori të ndryshme studentësh	X	X	
Tarifa të lidhura me performancat	X	X	
Tarifa njësoj për të gjithë			X

Siç tregon tabela, Kosova mbetet një nga vendet e pakta në botë ku tarifat janë të njëjta për të gjithë studentët në të gjitha nivelet e studimit (bachelor, pasuniversitar).

Masat e propozuara

Ligji do të duhej, me automatizëm, të subvencononte studimet e tri kategorive të studentëve: (a) më të mirët, (b) studentët nga familjet e varfëra, dhe (c) studentët që studiojnë fusha prioritare për shtetin. P.sh. një tjetër paragraf mund t'i shtohet Nenit 41, ku thuhet:

> Ministria do t'i miratojë aktet nënligjore ose rregulloret për t'i diversifikuar tarifat për studentët në bazë të arritjeve akademike, si dhe duke u bazuar në fushat specifike që i kërkon tregu.

Kjo do t'i lejojë qeverisë dhe IAL-ve me i rritë stimujt që studentët të studiojnë fusha të veçanta të kërkuara nga tregu. Ka p.sh. mungesë të madhe mësuesish të matematikës në të gjitha nivelet e arsimit. Duke përdorë këtë metodë të përcaktimit të tarifave, qeveria mund t'i rrisë stimujt për t'i studiuar shkencat. Një ndarje e mundshme e fondeve mund të organizohet si vijon:

Studentët	Skema financiare	Fushat prioritare
20% më të mirët e më të varfërit	Heqje tarifash dhe kredi për shpenzime të jetesës.	Heqje tarifash dhe bursë për shpenzime të jetesës.
20-50% më të mirët/më të varfërit	50% ulje tarifash dhe kredi e disponueshme për 50% tjetër dhe shpenzime të jetesës.	Heqje tarifash dhe kredish për shpenzime të jetesës.
50-80%	25% ulje tarifash dhe kredi deri në 50% të krejt shpenzimeve.	50% ulje tarifash dhe kredi për kosto studimesh.
20% i fundit	Pa ndihmesë as kredi. Paguan vetë gjithçka.	Ofroni ritrajnim profesional.

Miratimi i skemës së propozuar më lartë do të shpërblente më të mirët e më të zgjuarit dhe do ta inkurajonte punën e gjithë sistemit, sidomos orientimin e studentëve drejt

fushave prioritare. Njëkohësisht, programi i vënies së tarifave do ta zhvillonte më tej arsimimin e kosovarëve të varfër. Një skemë e ngjashme mund të miratohet për studimet pasuniversitare. Edhe ajo skemë do ta lehtësonte ndarjen e fondeve dhe do t'i rriste shpenzimet për arsim pa e rritur buxhetin.

Përfitimet

Sikurse propozimet e përmendura tashmë, përshtatja e tarifave të shkollimit kështu do të rriste punësimin e të diplomuarve, që pastaj do t'i mbushin nevojat e tregut të punës, duke stimuluar rritjen ekonomike. Përveç këtyre përfitimeve, subvencionimi i arsimit të lartë për kosovarët më të varfër do të përmirësonte perspektivat e tyre për punësim, duke çuar përfundimisht në reduktime të niveleve të larta të varfërisë. Kur më shumë njerëz punësohen, ekonomia rritet me normë më të shpejtë. Veç kësaj, kjo do të çojë në reduktim në pabarazinë e të ardhurave, duke stimuluar më tej rritjen ekonomike.

Propozimi 5: Shtim i llogaridhënies nëpër sistemin e arsimit të lartë

Ligjet dhe dokumentet e tjera ligjore sigurojnë kuadrin për llogaridhënie, por ka pak përgjegjshmëri në gjithë sistemin. Kur diskutohet llogaridhënia, është me rëndësi me lëvizë përtej përgjegjësisë financiare, që është shqetësimi kryesor i rregullativës aktuale mbi arsimin e lartë.

Rregullorja aktuale përqendrohet në llogaridhënie financiare, me dispozita të veçanta që caktojnë rolet e Bordeve dhe të Senateve kundrejt Ministrisë dhe Qeverisë.

> Bordi i një institucioni publik të arsimit të lartë është kolektivisht përgjegjës para Ministrit, për përdorimin e duhur, të efektshëm dhe transparent të fondeve që caktohen për institucionit nga Qeveria ose burime të tjera publike.[26]

Kjo përgjegjësi ndalet në ndjekje rregullash e procedurash, dhe nuk shikon "vlerë për para". Më konkretisht, rregullorja aktuale nuk siguron se tatimpaguesit po marrin rezultate të vlefshme nga taksat e tyre. Në thelb, zyrtarët nuk po veprojnë në interesin më të mirë të tatimpaguesve. Projektligji parashikon paraqitjen dhe vlerësimin e raportit të performancës:

> Për çdo vit akademik, institucionet publike të arsimit të lartë ia paraqesin raportet vjetore Ministrit mbi aktivitetet e kryera, performancat vjetore, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik dhe elementet tjera të përcaktuara me udhëzim të Ministrit. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se më 31 mars të vitit vijues.[27]

Theksi vihet mbi menaxhimin e financave:

> Nëse, siç vlerësohet nga Ministri i cili bazohet në raportet përfundimtare dhe rekomandimet nga Zyra e

> Auditorit të Përgjithshëm, çështjet financiare ose të tjera në një institucion janë ose po menaxhohen keq, ose dispozitat ligjore nuk janë zbatuar në pajtim me këtë ligj dhe statuti, Ministri mund të japë udhëzime në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e institucionit që ministri e sheh të arsyeshme, duke përfshirë, shkarkimin dhe zëvendësimin e përkohshëm të një apo më shumë anëtarëve të këshillit apo rektori. Të gjitha vendimet e tilla ratifikohen nga Kuvendi brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh.[28]

Fatkeqësisht, asnjë dispozitë nuk kërkon raportim për cilësinë e mësimdhënies dhe nëse të diplomuarit po fitojnë aftësi reale.

Përvojë për krahasim

Shumica e vendeve shkojnë përtej përgjegjësisë financiare për arsimin e lartë. "Pothuajse të gjitha vendet sigurohen që IAL-të jenë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike të tyre duke e lidhur të paktën një pjesë të shumës me performancën [e institucioneve]." [29] Planet institucionale strategjike, të detyrueshme në shumicën dërrmuese të vendeve, përbëjnë edhe një mjet që mund të masë arritjet institucionale. Në disa vende, kjo mund të ketë ndikim mbi sasinë e fondeve publike që institucionet marrin.

Modelet e matjes së performancës				
	Franca	Austria	Finlanda	Kosova
Kontratat e performancës	X	X		
Objekte sasiore			X	
Vetëm dispozita financiare				X

Për shembull, qeveria finlandeze konsideron arritjen e objektivave të caktuara sasiore kur përcakton fonde për IAL. Llogaridhënia përfshin "transparencën e aktiviteteve institucionale, veçmas raportimin mbi trupin financues dhe publikimin e rezultateve të vlerësimeve të brendshme dhe informacioneve mbi hulumtimin, mësimdhënien dhe financat."[30] Kështu, një numër në rritje aktorësh, përtej

zyrtarëve publik, përfshihen në sigurimin e llogaridhënies.

Masat që buxhetojnë me objektiva nuk janë të shtrenjta për zbatim dhe mund të bëhen pavarësisht nga sfondi social-ekonomik i një vendi.

Masat e propozuara

Ligji, si dhe nivelet e tjera të rregullativës në sistemin e arsimit të lartë, duhet të nxisin dhe të inkurajojnë më shumë përgjegjshmëri në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ndonëse aktualisht llogaridhënia kuptohet veç në aspektin financiar, ajo duhet të kërkohet në veçanti në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, rezultateve dhe vlerës për para në shpenzimin e fondeve publike[31].

Ligji duhet të fokusohet në matjen e treguesve specifikë që lidhen me punë të tilla si: numri i studentëve që diplomojnë në kohë, numri i studentëve që gjejnë punësim mënjëherë pas diplomimit, etj. Kjo lloj përgjegjësie do ta zhvendosë fokusin nga shqetësimi veç për përgjegjësinë financiare te përqendrimi në mësimdhënie, hulumtim dhe trajtim nevojash të tregut.

Ky ndryshim mund të fillojë duke ia përshtatë Nenin 44 projektligjit aktual për të mundësuar më shumë matje të performancës, veçanërisht në raport me rezultatet, pas të cilave, legjislacioni sekondar dhe rregulloret duhet të përditësohen me i përfshi si ndryshime.

Përfitimet

Duke matur tregues të caktuar si shkalla e diplomimit dhe punësimit, qeveria do t'i mbajë IAL-të përgjegjëse për cilësinë e mësimit në to. Nuk ka asnjë dispozitë eksplicite që i shërben këtij qëllimi aktualisht. Kjo do ta përmirësojë arsimimin që u ofrohet studentëve dhe do të krijojë kthime më të mëdha në investimet e tyre për shkollim të lartë. Kjo është një tjetër mënyrë se si qeveria mund të planifikojë arsim të lartë për t'iu dalë përballë nevojave të tregut, dhe kështu të ndikojë në rritjen ekonomike.

Propozimi 6: Konkurrencë mes universiteteve plotësisht autonome

Qeveria e Kosovës aktualisht ua jep paratë e taksapaguesve IAL-ve pa e ditë konkretisht se për çfarë shfrytëzohen ato. Zbatimi i propozimeve të këtij hulumtimi do t'i mundësonte qeverisë që të shohë tregun dhe të vendosë se nga cili ofrues i arsimit të lartë dëshiron të blejë dhe çfarë sasie të shërbimeve. Ky veprim mund të shoqërohet duke u lejuar institucioneve më shumë autonomi në vendosjen e tarifave dhe duke e kthyer qeverinë në blerës shërbimesh.

Aktualisht, tarifa vendoset nga Ministri i Arsimit;

> Ministri përcakton me akt nënligjor, që shqyrtohet çdo vit, me shkollim maksimal që duhet paguar nga studentët e pranuar në institucion publik të arsimit të lartë, të financuar nga Qeveria.[32]

Duke u nisur nga kjo e drejtë e dhënë nga Ligji për Arsimin e Lartë, në maj 2014 Qeveria e Kosovës vendosi t'i ndryshonte tarifat për studimet themelore nga 50 euro për semestër në 25. Me një shfaqje duarsh nga ana e Qeverisë, të hyrat vetanake të Universitetit të Prishtinës (dhe të institucioneve të tjera publike) u përgjysmuan. Ndërsa autonomia në arsimin e lartë kuptohet zakonisht si autonomi në vendimmarrje akademike, më shumë autonomi në përcaktimin e tarifave mund të lidhet me lëvizjen drejt rritjes së përgjegjësisë, nëse qeveria është e lirë me ble një shërbim ku konsideron se merr vlerën më të mirë për pare.

Përvojë për krahasim

Vende të ndryshme kanë qasje të ndryshme për ngritjen e tarifave në arsimin e lartë. Ndërsa një numër vendesh avokojnë për mosrregullim shumë herët (si Zelanda e Re) vende të tjera mbajnë vënien e tarifës nën kontroll të fortë (Kanadaja dhe shumica e vendeve evropiane). Në Ballkanin

Perëndimor ka qasje të ndryshme: në Shqipëri, Ministria përcakton tarifat, në Mal të Zi, tarifat përcaktohen nga Këshilli i Universitetit (Bordi) me miratimin e Ministrisë, ndërsa në Kroaci dhe Maqedoni universitetet kanë lirinë me i vendosë tarifat, por qeveria financon vetëm kategori të caktuara studentësh, duke i lënë të tjerët t'i gjejnë fondet vetë[33].

Kush i cakton tarifat e mësimit ë vende të ndryshme?						
	BE	ZR	SHQ	MZ	KRO	KS
Qeveria	X					
Ministria			X			X
Bordi i universitetit				X		
Udhëheqësia e universitetit (Rektorët)		X			X	

Shqetësimi më i madh lidhur me autonominë e shtuar për caktim tarifash është parandalimi i kërcimeve të mundshme në normat e tarifave. Megjithatë, legjislacioni mund të sigurojë mekanizma që mund ta parandalojnë rritjen e papritur të tarifave nga institucionet.

Masat e propozuara

Qeveria duhet të lejojë autonomi më të madhe në lidhje me përcaktimin e tarifave nga IAL-të. Kjo autonomi duhet kombinuar me diversifikimin e financimit të studentëve nga ana e qeverisë, me fokus të shtuar në llogaridhënie. Kjo do t'a mundësonte arritjen e një marrëveshjeje të duhur kontraktuale ndërmjet Qeverisë dhe ofruesve të arsimit të lartë, duke qartësuar çka po blen qeveria dhe çka po ofrojnë universitetet. Qeveria mund të ofrojë bono për studentët, të cilët do të vendosin në cilën IAL duan t'i shpenzojnë bonot.

Për pjesën tjetër të shërbimeve, IAL-të mund të kërkojnë çkado që mendojnë se tregu është i gatshëm të paguajë. Kjo

do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës në sektorin e arsimit të lartë në mbarë vendin. Për të lejuar vendosje autonome tarifash, Neni 41 i projektligjit aktual duhet të përshtatet me punën e mëtejme që kërkohet në nivelin e legjislacionit sekondar dhe statuteve e rregulloreve të universitetit.

Përfitimet

Përfitimet nga miratimi i këtij propozimi janë të ngjashme me përfitimet që dalin nga miratimi i Propozimit 1. Të dyja këto masa u mundësojnë institucioneve individuale autonomi të shtuar, me të cilën mund të dallohen nga njëri-tjetri në sytë e klientëve të mundshëm (studentë e prindër). Duke ofruar bono për disa studentë, qeveria do t'i zgjerojë mundësitë për ata studentë të veçantë, duke i lejuar të bëjnë zgjedhje më efikase dhe praktike kur të vendosin se cilin IAL t'a vijojnë. Nga ana tjetër, programi me bono do të stimulonte shkollat që të përpiqeshin me tërheqë një gamë të gjerë studentësh. Kjo do të krijonte konkurrencë të mëtejme mes institucioneve, për të siguruar produkt me cilësi të lartë.

Propozimi 7: Futja e hulumtimit si kategori për financim në universitet

Aktualisht, fokusi kryesor i financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë është te mësimdhënia. Financimi për hulumtim pothuajse mungon në praktikë. Universitetet marrin fonde të dedikuara për hulumtime nga Ministria e Arsimit, dhe duhet të aplikojnë çdo vit për financimin të hulumtimeve nëpërmjet një procesi të veçantë (shih Propozimin 8). Kjo nxit dekurajime për t'u përqendruar në kërkime nëpër universitete dhe çon në rezultatet të kufizuara shkencore në Kosovë. Prandaj, në këtë drejtim Kosova mbetet seriozisht prapa rajonit[34].

Projekt-ligji aktual është shumë sipërfaqësor në sa me financimin për hulumtime. Neni 39 thotë:

> Qeveria vënë në dispozicion fonde publike për të përkrahë institucionet publike të arsimit të lartë, duke përfshirë edhe programet e tyre të studimit, të kërkimit shkencor, të edukimit të vazhdueshëm dhe aktivitete të mësimit të përjetshëm, në infrastrukturën dhe menaxhimin e tyre, si dhe të studentëve të tyre, në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesat strategjike të vendit.[35]

Ligji thotë se financimi lidhet drejtpërdrejt me numrin e studentëve të miratuar (siç ceket në propozimet e mëparshme), duke i lidhë kështu *de facto* fondet me ngarkesën mësimore, të matur veç me një llogaritje sipas numrit të studentëve.

Përvojë për krahasim

Në Evropë ka dy metoda kryesore të financimit të arsimit të lartë publik. E para është *financimi bazë për hulumtim*, që d.m.th. institucioni mund t'i përdorë fondet si të dojë. Grantet mund të jepen specifikisht për

hulumtim [ose] t'i shtohen një granti bllok për lloje të tjera shpenzimesh, përkatësisht mësimdhënie dhe/ose veprimtari operacionale." [36] Mënyra e dytë është të ofrohen fonde nëpërmjet një *procedure tenderimi konkurrues*. Në shumicën e vendeve evropiane,

> "fondet publike për hulumtime ofrohen nën një sistem mbështetjeje të dyfishtë, të përbërë nga financimi bazë për hulumtim [...] dhe dhënia e fondeve publike në baza konkurruese për projekte të caktuara kërkimore. Në Rumani [...] i vetmi mekanizëm financues i hulumtimit në arsimin e lartë përfshin një procedurë të tenderimit konkurruese për projekte të veçanta kërkimore." [37]

Financimi i hulumtimit të institucioneve të arsimit të lartë				
	MB	Bullgaria	Finlanda	Kosova
Financim i veçantë për hulumtim	X	X	X	
Procedurë tenderimi konkurrues	X	X	X	X*
Financim për projekte specifike	X	X	X	
Financim hulumtimi si pjesë e grantit mësimor				X

*në nivel shteti

Sipas Komisionit Evropian, në shumicën e vendeve,

> burimi financues për projekte specifike kërkimore zakonisht është një organ shtetëror i specializuar në kërkim dhe zhvillim (si fondit kombëtar shkencor, akademia kombëtare ose këshilli kërkimor), kurse financimi bazë për kërkime shpërndahet nga i njëjti organ që jep përkrahje financiare për aktivitetin mësimdhënies dhe operacional. Në disa vende si Bullgaria, Finlanda dhe Mbretëria e Bashkuar (Skocia), shumica e financimit publikut për kërkime synohet për projekte specifike. [38]

Masat e propozuara

Qeveria duhet të prezantojë fondet për hulumtime si kategori të veçantë të fondeve qeveritare për IAL-të, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Financimi për hulumtim duhet bazuar në objektiva të qarta dalëse të lidhura me prioritetet në sektorë të veçantë të aktivitetit ekonomik, si numri i punimeve të publikuara, ndikimi i tyre, numri i projekteve të bashkëfinancuara me sektorin privat. Studimet e doktoraturës të subvencionohen dhe të lidhen me rezultatet specifike kërkimore. Kjo do të shënonte shkëputje të qartë nga praktika e tanishme, duke lëvizë nga studimet e doktoratës me qëllime krejt akademike për studime që plotësojnë nevojat e sektorit privat, ose u përgjigjen dilemave të politikave publike të sektorit publik.

Përfitimet

Duke marrë financime të caktuara vetëm për hulumtime, institucionet e arsimit të lartë do të kenë më shumë liri për projekte më të gjera dhe më të mëdha kërkimore. Shkollat s'do të duhen me vendosë më se cilat tema kërkimore janë të denja për të kanalizuar fonde nga fusha të tjera të nevojshme. Studime më të shtrenjta e më të larmishme mund të ndërmerren nga stafi i IAL-ve dhe studentët. Studentët do të përfitojnë duke marrë më shumë përvojë kërkimore. Veç kësaj, financimi për funksione të tjera të institucioneve s'do të duhej të sakrifikohej më për hulumtime. Të gjitha veprimet e IAL-ve do të përfitonin nëse qeveria jep fonde specifike kërkimore për universitetet.

Propozimi 8: Të lidhen fondet për hulumtime me nevojat e tregut

Fondet publike për hulumtime në Kosovë ndahen në mënyrë joefikase. Çdo vit, MAShT-i u jep fonde kërkimore universiteteve, instituteve kërkimore, dhe organizatave të tjera, publike e private. Megjithëse financimi jepet në bazë të një procesi konkurrues (shpallë përmes procedurave të tenderimit), ai shpeshherë nuk lidhet me fushat e rëndësisë strategjike ose nevojat e tregut. Njëherësh, pothuajse çdo vit, Departamenti i Shkencave në MAShT nuk merr mjaft propozime për ta shpenzuar tërë buxhetin e alokuar për kërkime. Së fundi, procesi i kontrollit të cilësisë së rezultateve të hulumtimit nuk është transparent. Nuk ka asnjë burim në dispozicion (baza të të dhënave, website, etj.), ku publiku mund të gjejë hulumtimin e kryer me fonde publike.

Kërkimi shkencor dhe veprimtaria krijuese rregullohen me Ligjin për aktivitetet shkencore-kërkimore, aktet e zbatueshme ligjore e nënligjore, si dhe nga statutet e institucioneve të arsimit të lartë. Ligji për Arsimin e Lartë rregullon krejt përciptazi veprimtarinë shkencore të IAL-ve:

> Varësisht nga statusi i tyre si Universitet, kolegj Universitar, Kolegj i Arsimit të Lartë ose lloj tjetër institucioni, institucionet publike të arsimit të lartë kryejnë aktivitetet bazë ose kërkimore-shkencore të aplikuara, studimet dhe projektet për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutet e tyre, sipas natyrës dhe objektivave specifikë të institucionit. Ato sigurojnë integrimin e veprimtarisë kërkimore në aktivitetin e tyre të mësimdhënies.[39]

Në praktikë, kjo dispozitë domethënë se hulumtimi shihet si fakultativ, nga qeveria e profesorët. Kjo çon në situatën që Kosova të mbetet prapa rajonit në numër artikujsh

shkencorë të botuar në punimet e indeksuara SCOPUS (rreth 650 punime krejt), pa tendencat që të tregojnë zhvillime pozitive në vitet e fundit. [40]

Ka institucione shkencore brenda shumicës së universiteteve, por për shkak të mungesës së stimujve shumica e tyre nuk prodhojnë shumë në rrafshin shkencor. Sipas Ligjit aktual për arsimin e lartë, këto institute nuk njihen si subjekte zyrtare dhe si të tilla nuk kanë llogaritë e tyre bankare apo çdo lloj autonomie financiare. Çdo financimit që ata të mund të marrë me donatorë apo granteve të tjera duhet të kalojnë përmes sistemit universitar qendror, duke e bërë të vështirë për të marrë fonde nga universiteti se në qoftë se ajo erdhi direkt nga donatorët e jashtëm.

Përvojë për krahasim

Dy metoda përdoren rëndom për ta përcaktuar sasinë e fondeve për kërkime dhënë institucioneve të arsimit të lartë: kritereve të lidhura me të hyra, bazuar këto në koston e aktiviteteve kërkimore ose të performancës institucionale të lidhur me punë kërkimore. Ndonjëherë të dyja metodat janë përdorë për ta llogaritur shumën e përgjithshme për kërkime për institucione publike. Në të dyja situatat, vendet zakonisht përdorin indikatorët e performancës si mënyrë për ta stimuluar konkurrencën mes institucioneve, duke arritur cilësi më të lartë hulumtimesh. [41] Vendet që u referohen prurjeve kërkimore, zakonisht përqendrojnë kriteret mbi numrin e studentëve të doktoraturës dhe/ose numrin e anëtarëve të stafit që punojnë në një fushë të caktuar hulumtimi. "Ata mund të përqendrohen në shkallën e aktiviteteve kërkimore të ndërmarra (Malta) ose në kostot e fundit në këtë fushë (Bullgari, Danimarkë e Islandë)."[42]

Kriteret për financimin e hulumtimeve

	Malta	Denimarka	Bullgaria	Kosova
Prurje hulumtimesh	X	X	X	
Konkurrenca	X	X	X	X
Tregues performancash	X	X	X	

Të shumtën e herës, kur hulumtimi financohet publikisht, vendet përdorin vlerësimin kolegial si procedurë e që masin forma të ndryshme të treguesve të performancës. Siç përshkruhet në dokumentin kyç prej Komisionit Evropian:

> Në një shumicë dërrmuese vendesh, mekanizmat që ndajnë grante hulumtimi stimulojnë konkurrencën mes institucioneve, duke e drejtuar përmbajtjen e hulumtimeve drejt prioriteteve kombëtare. Kjo arrihet, së pari, nëpërmjet fondeve shumë të gjëra publike për projekte të hartuara ose të miratuara në nivel kombëtar, për të cilat institucionet konkurrojnë duke aplikuar; dhe së dyti, si rezultat i treguesve të performancës që shumë vende i përdorin për të llogaritur nivelin e tyre themelor për financimin e grantit për hulumtim.[43]

Kësisoj, vendet pëlqejnë zhvillimin intelektual në fusha me rëndësi kombëtare, ndërsa krijojnë kështu konkurrencë mes universiteteve për të dalë me rezultate më të mira.

Masat e propozuara

Lidhja e hulumtimit me nevojat e tregut është parakusht themelor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Prandaj, qeveria duhet t'i përdorë fondet e dhëna për universitete në mënyrë konkurruese, për të vendosur kritere specifike në marrëveshjet e performancës për t'u shërbyer nevojave të industrisë. Kjo do të jetë veçanërisht e dobishme në vendet më pak të zhvilluara ekonomikisht. Kosova nuk është në ballë të shkencës, dhe duhet ta maksimizojë dobinë e burimeve të pakta që ka për të plotësuar nevojat e veta.

Vëmendje ligjore duhet t'i jepet marrëveshjeve të performancës, duke u siguruar se ekzistojnë mekanizma për zbatimin e tyre. Dy veprime kryesore duhen ndërmarrë:

- Ligji për Arsimin e Lartë duhet t'u ofrojë më shumë stimuj instituteve shkencore për të bërë hulumtime, duke u lejuar institucioneve më shumë autonomi financiare.
- Ligji për Kërkimet Shkencore duhet të prezantojë matjet e performancës si kriter në dhënien e fondeve kërkimore për institucionet publike dhe private.

Përfitimet

Ka një lidhje direkte mes fondeve qeveritare specifike për kërkime dhe zhvillimit ekonomik. Duke inkurajuar IAL-të për të kryer kërkime në sektorë të veçantë ekonomikë, ku hulumtimi është më se i nevojshëm, qeveria mund ta stabilizojë drejtpërdrejt tregun dhe ta nxitë më tej rritjen. Matja e treguesve specifikë për kërkime, duke i mbajtur IAL-të dhe hulumtuesit përgjegjës për punën e tyre, do të sigurojë që paratë të shpenzohen me efikasitet. Po ashtu, nëse IAL-të drejtpërdrejt po shqyrtojnë çështje me rëndësi për tregun, studentët do të fitojnë aftësi të vlefshme dhe lidhje për punësim në të ardhmen.

Propozimi 9: Të prezentohen stimuj për funksionimin e bordeve industriale

Një nga sfidat më të mëdha në arsimin e lartë në Kosovë është furnizimi i tregut të punës me fuqi punëtore të nevojshme. Shumë vlerësime tregojnë se mungesa e një fuqie punëtore të aftë mbetet ndër pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Sondazhet e firmave prodhuese tregojnë se një numër i madh firmash (25 deri 50 për qind, në varësi të sektorit) hasin në vështirësi me gjetjen e punëtorëve të kualifikuar.[44] Kjo tregon se problemet e papunësisë dhe normat e ulëta të aktivitetit nuk janë të lidhura vetëm me norma të ulëta të rritjes ekonomike (d.m.th. numër të vogël vendesh pune të krijuara), por edhe për punësimin e fuqisë punëtore, veçanërisht furnizimi ulët të punëtorëve të lartë të aftë të nevojshme nga kompanitë . Njëzet e pesë për qind e kompanive të Kosovës pohojnë se fuqia punëtore ka aftësi joadekuate, ndërsa më shumë se tetëdhjetë e pesë për qind e investitorëve deklarojnë se cilësia e punës është faktori më i rëndësishëm në vendimet për investime.[45]

FMN ka vlerësuar së fundmi se pavarësisht kostove të ulëta të përgjithshme, kostot e punës në Kosovë mbeten më të shtrenjta se në rajon, kur përshtaten për produktivitet.[46]

Bordet industriale janë element i rëndësishëm në lidhjen e nevojave të industrisë me sistemin arsimor. Një numër në rritje i fakulteteve brenda UP-së si dhe universitete të tjera publike në Kosovë kanë caktuar ose janë në proces të caktimit të bordeve industriale.

Bordet industriale nuk mandatohen me ligj dhe nuk janë as nuk përmenden në statutet e universiteteve të Kosovës. Megjithatë, Universiteti i Prishtinës i sheh bordet industriale (të cilat janë ngritur me ndihmë nga jashtë), si një nga elementet kyç për t'i përfshirë nevojat e industrisë

në zhvillimin e kurrikulave, sidomos në nivelet Master dhe PhD.[47]

Përvojë për krahasim

Bordet industriale në disa vende funksionojnë si borde niveli të lartë të të besuarve, të përbëra shumë nga udhëheqës të industrisë, aktivë e në pension. Këta zakonisht takohen disa herë në vit dhe fokusin kryesor e kanë të ofrojnë udhëzime për dekanin dhe fakultetin mbi qëllimet arsimore dhe si ato të arrihen. Kjo do të përfshinte dhënien e këshillave mbi përshtatshmërinë e kurrikulave, përfshirjen e industrisë në procesin e mësimdhënies, ndihmesën me fillestarë, etj. Një praktikë e ngjashme ndiqet në disa institucione private edhe në Kosovë. P.sh. bordi i AUK përbëhet nga një numër liderësh në fushën e biznesit, politikës dhe diplomacisë, vendorë këta e ndërkombëtarë. Bordi mblidhet disa herë në vit dhe vendos prioritetet për universitetin, si dhe vlerëson rezultatet e arritura.

Masat e propozuara

Projektligji duhet parë si mundësi për ta inkurajuar përdorimin e bordeve industriale. Stimuj (shpërblime) u duhen ofruar dekanëve që angazhohen me borde industriale, pasi kjo është në interes të tregut të punës dhe të vendit. Edhe dekurajimet duhen prezentuar për dekanët që nuk përpiqen t'i përshtatin programet me nevojat e tregut, në këtë rast të përfaqësuara nga bordi i industrisë. Njëherësh, IAL duhen inkurajuar për t'i përfshirë këto borde në klasë dhe në punë praktike. Mund të miratohen akte përkatëse nënligjore për ta rregulluar funksionimin dhe llogaridhënien e këtyre bordeve. Kjo praktikë mund të zgjerohet edhe për bordin drejtues të Universitetit. Për shembull, tre anëtarë të bordit të Universitetit mund të emërohen nga komuniteti i biznesit përmes bashkëpunimit me Odat Ekonomike ose me ndonjë modalitet tjetër. Së

fundmi, Universiteti mund ta krijojë praktikën e rangimit të të diplomuarve nga departamente të caktuara nga ana e punëdhënësit. Ky proces mund të menaxhohet edhe me Odat Ekonomike dhe mund të llogaritet drejt financimit vjetor të institucionit.

Përfitimet

Bordet industriale do të jetë në gjendje t'i orientojnë universitetet drejt nxjerrjes së të diplomuarve më të punësueshëm me aftësi të vërteta e të dobishme. Këto borde do të dinë t'i këshillojnë IAL se çfarë kërkohet në treg dhe sa më mirë të kënaqen ato nevoja, kurse universitetet do të jenë në gjendje ta përshtatin më mirë kurrikulën për t'u siguruar se të diplomuarit kanë aftësitë e nevojshme në treg.

Propozimi 10: Të lidhet paga me performancë

Një kohë të gjatë, për cilësinë e ulët në arsimin e lartë fajësoheshin pagat e ulëta. Që nga viti 2008, pagat e personelit mësimdhënës janë trefishuar, duke i tejkaluar pagat në shumicën e vendeve fqinje. Ndërkohë, cilësia e arsimit të lartë ka vazhduar të bjerë dhe shumica e treguesve i nxjerrin shkollat në Kosovë poshtë shumicës së institucioneve në Ballkanin Perëndimor. Kjo do me thënë se taksapaguesit e vendit më të varfër në rajon, Kosovës, duhet ta bartin mbi supe barrën e sistemit më së paku efikas të arsimit të lartë.

Pagat e personelit akademik nuk rregullohen me Ligjin për Arsimin e Lartë, por përmes një kombinimi të legjislacionit ndërmjet Ligjit mbi Shërbimin Civil, Ligjit për Pagat e Zyrtarëve Publikë dhe akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Administratës Publike. Stafi akademik merr pagën e tyre bazë plus pagë shtesë që lidhet me mësimin shtesë, si dhe pagën e lidhur me numrin e studentëve që hyjnë për një provim. Kjo paraqet një dekurajim të drejtpërdrejtë për t'u përqendruar në suksesin e studentëve si tregues të performancës[48].

Shumë profesorë marrin pagë të katërfishtë dhe paga mesatare është rreth dyfishi i pagës së parashikuar për një punë të plotë.

Përvojë për krahasim

Në Bashkimin Evropian, sipas Komisionit Evropian, vendet e ndryshme përdorin metoda të ndryshme për përcaktimin e të ardhurave të stafit akademik.

> Në rreth gjysmën e vendeve, paga vjetore bruto përcaktohet kryesisht nga autoritetet qendrore (legjislacioni dhe dokumentet zyrtare). Në shumicën e

> këtyre vendeve, ky vrojtim ndërlidhet me statusin (e nëpunësit civil) të stafit akademik. Në gjysmën tjetër të vendeve, ky proces bazohet në fuqinë e përbashkët të vendimmarrjes (shteti/institucionet).[49]

Mirëpo, në disa vende (si Suedia) çdo individ gëzon rrogën në bazë të performancës së vet.[50]

Mënyrat e pagesës së personelit akademik				
	Letonia	Suedia	Austria	Kosova
Rrogë vjetore fikse	X		X	X
Lidhet me statusin e nëpunësit civil		X	X	
Bonuset lidhen me performancën dhe kohën në shërbim	X	X	X	
Bonuset bazohen në detyra shtesë (provime, mbikëqyrje tezash)				X

Për më shumë, bonuset, sipër pagës bazë, ofrohen në shumicën e vendeve. Bonuset zakonisht bazohen në performancën e stafit akademik dhe kohën në punësim.[51] Bonuset dhe koha shtesë nuk mund të arrijnë te një pagë e dytë.

Masat e propozuara

Ligji aktual për pagesën në arsimin e lartë duhet të përshtatet që kryesisht të përqendrohet në performancën e stafit. Kjo d.m.th. të mbahen pagat bazë për gjithë stafin dhe të hiqen stimujt e lidhura me mësimdhënien shtesë, administrimin e provimeve, etj. Përkundrazi stimujt duhen të lidhen me hulumtimin, përsosjen e mësimdhënies dhe vlerësimin nga studentët. Një formulë e mundshme mund të operojë kështu:

> Paga bazë + Bonuse në bazë të kohës në shërbim + Bonuse në bazë performance

Paga bazë - do të ishte fikse në bazë të titullit akademik dhe

shkallës akademike të personelit. Kjo pagë bazë do të përfshinte mësimdhënien dhe hulumtimin, plus aktivitete të tjera si notat dhe administrimi i provimit, mbikëqyrja e tezës, etj.

Bonuset për kohën në shërbim – do të bazoheshin në vitet e shërbimit brenda institucionit. Këto mund të lidhen edhe me një kategorizim potencial të pozicioneve si të përhershme ose jo.

Bonuset e bazuara në performancë - këto do të lidheshin me të arriturat e veçanta të departamentit a institucionit. Mund të bazohen në numrin e nxënësve që gjejnë punë brenda vitit të parë pas diplomimit, numrin e studentëve të diplomuar brenda tre vjetësh, etj.

Përfitimet

Duke i bazuar pagat e profesorëve në faktorë tjerë e jo në numrin e studentëve që hyjnë në provime, përfitojnë në masë të madhe studentët. Struktura aktuale e pagave është e dëmshme, i nxit profesorët që t'i ngelin studentët për t'i detyruar të hyjnë prapë në provime. Duke e bazuar pagën në tregues të dobishëm, si hulumtimi dhe vlerësimet e studentëve, i gjithë sistemi IAL-ve do të përfitonte nga profesorët më produktivë. Bonuset për kohën në shërbim janë me rëndësi sepse i nxisin profesorët të punojnë në të njëjtin institucion për disa vite, duke i zhvilluar aftësitë e mësimdhënies dhe të hulumtimit. Nga bonuset në bazë punësimit të të diplomuarve do të përfitonin studentët, profesorët dhe tregu, duke prodhuar më shumë të diplomuar të punësueshëm.

Propozimi 11: Kontrolli dhe balancimi

Suksesi i propozimeve të parashtruara në këtë dokument varet shumë nga funksionimi i përgjithshëm i kontrolleve dhe balancave në qeverisjen e arsimit të lartë në Kosovë.



Siç tregon diagrami, tri çështje të mëdha ekzistojnë në sistemin aktual të kontrolleve dhe balancave: (a) nuk ka mekanizëm nga poshtë-lart që ta mbajë të përgjegjshëm menaxhmentit e nivelit më të lartë, si Bordet ose Rektorët, para stafit të IAL-ve; (b) ka konflikt interesash mes zyrtarëve të qeverisë dhe personelit të IAL-ve; dhe (c) dekanët e profesorët në komisionet qeveritare më shpesh

interesohen ta ruajnë status quo-në sesa t'u shërbejnë qytetarëve. Situata aktuale paraqet një dilemë tipike drejtor-veprues: vepruesit (deputetët) pritet ta përfaqësojnë interesin e drejtorëve të vet (votuesve), porse, për shkak të këtij konflikti interesash në sistem, drejtorët mbeten pa përfaqësim të duhur. Ky është çelësi për të vendosur mekanizmat përkatës për t'i mbajtur deputetët të përgjegjshëm, në mënyrë që të stimulohen t'i adresojnë interesat e studentëve dhe prindërve në arsim cilësie të lartë.

Veç dekurajimeve për llogaridhënie të shtuar në sistem, Komisioni Parlamentar për Arsim nuk ka shfaqur ndonjë interes të fortë në mbikëqyrjen e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. Sipas Rregullores së Kuvendit [52] komisioni është përgjegjës për trajtimin e çështjeve që lidhen me arsim, shkencë, teknologji, rini, sport e kulturë. Kjo i jep komisionit përgjegjësi të gjerë dhe të shpërqendruar. Për më shumë, rregullat e procedurës parashohin se komisioni është kryesisht përgjegjës për miratimin e rregulloreve/ligjeve të reja dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Ndërsa rregullat e procedurës nuk shprehin qartë përgjegjësinë për ta mbikëqyrë arritjen e performancës specifike nga institucionet IAL, kjo duhet parë si mundësi nga deputetët e Kuvendit që duan ta zgjerojnë përkrahjen e tyre zgjedhore duke mbrojtur interesat e tatimit-paguesve.

Masat e propozuara

Për t'i adresuar mangësitë e mësipërme në sistemin e kontrolleve dhe balancave, veçmas në nivelin e Kuvendit, sugjerohen rekomandimet e mëposhtme. Pozicionet e profesorëve të universitetit dhe të mjekëve i duhen shtuar listës së posteve publike që duhet të ngrihen ose të dorëhiqen para se ta shpallin kandidaturën për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me heqjen e këtij konflikt interesi,

deputetët do të kishin stimulime më të mëdha të shtyjnë për ndryshime në arsimin e lartë (tema e këtij hulumtimi), por edhe në fusha të tjera, si shëndeti.

Përfitimet

Shumica e propozimeve në këtë hulumtim janë dizajnuar për ta përmirësuar sistemin e IAL-ve duke adresuar stimujt e universiteteve, stafit dhe studentëve. Përfitimet nga ky propozim janë më shumë në nivel të sistemit se sugjerimet e diskutuara më parë. I tërë sistemi IAL-ve do të përfitojë direkt duke hequr këtë konflikt interesi në Parlament. Legjislatura do të jetë më e përgjegjshme ndaj nevojave të pjesës tjetër të akterëve në sistem dhe më fleksibile në adresimin e këtyre nevojave.

Përfundime

Në mënyrë që Kosova ta shfrytëzojë plotësisht kapitalin e vet njerëzor, ndryshime të rëndësishme duhen bërë në sistemin e arsimit të lartë. Sistemi aktual nuk stimulon sa duhet asnjë nga akterët në tërë zinxhirin komandues. Propozimet e bëra në këtë hulumtim do t'a ndryshojnë sistemin aktual për të rritur llogaridhënien tek të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e arsimit të lartë. Është e domosdoshme që universitetet t'i pajisin të diplomuarit me aftësitë e nevojshme për sukses në treg. Këto sugjerime do ta rrisin edhe produktivitetin e universiteteve dhe të studentëve, duke i pasqyruar nevojat e tregut të punës dhe nxitur rritjen shumë të nevojshme ekonomike dhe stabilitetin në Kosovë. Propozimet në këtë hulumtim përputhen plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar të miratuar së fundmi nga Zyra e Kryeministrit.

Krahas me diskutimet publike, ky hulumtim ofron një sërë rekomandimesh të veçanta për ndryshime në ligjin ekzistues, statutet e universiteteve, aktet nënligjore, si dhe mekanizmat e financimit.

Propozimet këtu janë sugjerime për deputetët për të përmirësuar sistemin, nëse ata zgjedhin për t'u shërbyer votuesve të tyre. Universitetet duan më shumë autonomi në legjislacionin e tyre, dhe financimi qeveritar duhet të drejtohet kah rezultatet e institucioneve. Konkurrenca do t'a shtojë përdorimin e shumave të njëjta të financimit dhe do t'i lirojë paratë publike për ta rritur pjesën e përgjithshme të GDP-së së shpenzuar për arsimim. Universitetet duhet të stimulohen që t'i inkurajojnë nxënësit me i ndjekë fushat e studimit që përkojnë me nevojat e tregut të punës. Përveç kësaj, metodat e reja të përcjelljes së performancës janë të nevojshme për të siguruar efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e të gjithë sistemit.

Përmirësimi i llogaridhënies më tej do të rriste cilësinë e

operimit dhe të rezultateve në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të lartë, nga profesorët te deputetët. Disa nga propozimet fillimisht mund të duken të ashpra, por kjo vetëm sepse kosovarët janë mësuar me mungesën aktuale të çdo lloj llogaridhënie në arsimin e lartë. Në fund të fundit, Universiteti i Prishtinës dhe universitetet publike të tjera janë përgjegjëse për dy milionë kosovarë që i mbajnë këto institucione me taksa dhe që për paratë e veta meritojnë të marrin vlerë më të mirë.

Referencat

[1] Zyra e Kryeministrit, "Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021," http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf, janar 2016, faqe 10 (qasur më 20 qershor 2016).

[2] Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 33/69 nga 18 nëntor 1969. Shih Statuti i Universitetit, gjendet në: http://www.uni-pr.edu/Files/Dokumente/Relevante/Statutiversioniifundit.aspx

[3] shih faqen e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Arsim http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,125, edhe legjislacionin më të vjetër http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,102

[4] shih biografitë e ministrave në webfaqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit http://www.kryeministri-ks.net/?faqe=1,43 (qasja më 13 qershor 2016).

[5] Statuti i Universitetit të Prishtinës, gjendet në: http://www.uni-pr.edu/Files/Dokumente/Relevante/Statutiversioniifundit.aspx

[6] Jeta në Kosovë, "Reformim apo Konfirmim?," YouTube video, 2016 https://www.youtube.com/watch?v=lrS963e20HI (qasja më 13 qershor 2016).

[7] Raport Vlerësimi, Plani Strategjik për Arsim i Kosovës 2011-2016, http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf, dhjetor 2015, faqe 56 (qasja më 13 qershor 2016).

[8] "Asistenti në UP i dyshuar për Doktorate Plagjiat," *Koha*, 11 mars 2013, http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=138188 (qasja më 13 qershor 2016).

[9] shih http://gazetanewborn.net/profesori-denoncim-publik-ndaj-tezes-se-doktoratures-te-dekanes-se-fakultetit-te-filologjise-lindite-rugova-dokument/. Email publik dërguar nga Prof. Enver Mehmeti të gjithë nëpunësve të Universitetit të Prishtinës më 2 shkurt 2016 (qasja më 13 qershor 2016).

[10] Raport Vlerësimi, Plani Strategjik për Arsim i Kosovës 2011-2016, Ministria për Arsim e Shkencë, http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf, dhjetor 2015, faqe 82 (qasja më 13 qershor 2016).

[11] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, Neni 27, paragrafi 2, Miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf (qasja më qershor 13, 2016).

[12] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, Neni 27, paragrafi 3, Miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf (qasja më 13qershor 2016).

[13] Joi Ito, Becoming a Professor, 2016, https://joi.ito.com/weblog/2016/06/02/becoming-a-prof.html (qasja më qershor 13, 2016).

[14] shih shembullin e Christopher Hill-it, http://www.du.edu/korbel/about/dean/

[15] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 39, paragrafi 4 (qasja më qershor 13, 2016).

[16] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 39, paragrafi 3 (qasja më qershor 21, 2016).

[17] Miroiu, Adrian dhe Lazar Vlasceanu, "Relating quality and funding: The Romanian Case," në *European Higher Education at Crossroads: Between the Bologna Process and National Reforms*, ed. Adrian Curaj, et al, Springer Science 2012, faqe XX.

[18] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë, 2011, http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf. Neni 44, paragrafi 2 (qasja më qershor 13, 2016); Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 44, paragrafi 2 (qasja më 13 qershor, 2016).

[19] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë, 2011, http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf. Neni 44, paragrafi 3 (qasja më qershor 13, 2016); Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni

44, paragrafi 3 (qasja më qershor 13, 2016).

[20] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 57 (qasja më 13 qershor 2016).

[21] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 50 (qasja më 13 qershor 2016).

[22] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 58 (qasja më 13 qershor 2016).

[23] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 52 (qasja më 13 qershor 2016).

[24] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë, 2011, http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf. Neni 41, paragrafi 1 (qasja më qershor 13, 2016); Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, Miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 41, paragrafi 1 (qasja më 13 qershor 2016).

[25] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë, 2011, http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf. Neni 41, paragrafi 2 (qasja më 13 2016); Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 41, paragrafi 2 (qasja më 13 qershor 2016).

[26] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 44, paragrafi 1 (qasja më 13 qershor 2016).

[27] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 44, paragrafi 2 (qasja më 13 qershor 2016).

[28] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 41, paragrafi 6 (qasja më 13 qershor 2016).

[29] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 65 (qasja më 13 qershor 2016).

[30] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG per Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 65, 66 (qasja më 13 qershor 2016).

[31] Ebersole, John, "A Discussion on Higher Education Accountability," *Forbes*, 23 shkurt 2015, http://www.forbes.com/sites/johnebersole/2015/02/23/a-discussion-on-higher-education-accountability/#31b165e8187b (qasur me 14 qershor 2016).

[32] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 41, paragrafi 1 (qasja më 13 qershor 2016).

[33] KDI (2016), Studim Krahasues per Projektligjin për Arsimin e Lartë, Diskutuar në tryezë të rrumbullakët në Prishtinë, shkurt 2016.

[34] Banka Botërore (2013), Western Balkans Regional R&D – Strategy for

Innovation, f.17. gjendet në:
http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Western-Balkans-R&D-Kosovo.pdf

[35] Kuvendi i Kosovës, Projektligj për Arsimin e Lartë, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-74.pdf, Neni 39, paragrafi 1 (qasja më qershor 13, 2016).

[36] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 60 (qasja më 13 qershor 2016).

[37] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG [er Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 60 (qasja më 13 qershor 2016).

[38] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 60 (qasja më 13 qershor 2016).

[39] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-135 mbi Veprimtarinë Shkencore e Hulumtuese, Gazeta zyrtare nr. 11, 2 maj 2013, https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/ligji-per-veprimtari-kerkimore-shkencore-2013-eng.pdf, Neni 10 (qasja më 14 qershor 2016).

[40] Banka Botërore (2013), Western Balkans Regional R&D – Strategy for Innovation, f.17. gjendet në:
http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Western-Balkans-R&D-Kosovo.pdf

[41]Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20r

eforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 61 (qasja më 13 qershor 2016).

[42] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 61 (qasja më 13 qershor 2016).

[43] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 63 (qasja më 13 qershor 2016).

[44] Çeku, Hajrulla, "Sector Profile of Tourism," Ministria për Tregti e Industri, 2014, http://mti-ks.org/repository/docs/Sector_profile_Tourism_130623.pdf, faqe 19 (qasja më 14 qershor 2016); Rizvanolli, Artane, "Sector Profile of the Plastics and Rubber Industry," Ministria për Tregti e Financa, 2016, http://mti-ks.org/repository/docs/ENG_PLASTIC_AND_RUBBER_INDUSTRY_REPORT_333810.pdf, faqe 21 (qasja më 14 qershor 2016).

[45] Zyra e Kryeministrit, "National Development Strategy 2016-2021, janar 2016, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf, faqe 13 (qasja më 14 qershor 2016).

[46] IMF (2016) First Review under the Stand-By Agreement, janar 2016. gjendet në: http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr1622.pdf

[47] shih Universiteti i Prishtinës faqe për Bordet Industriale, gjendet në: http://uni-pr.edu/Kerkime-Shkencore/Bordet-Industriale.aspxfaqe

[48] Gazetat kanë vite që raportojnë mbi çështjen: http://old.zeri.info/artikulli/9574/profesoret-me-3000-euro-paga or http://klankosova.tv/pagat-e-profesoreve-deri-ne-7-mije-euro-video/

[49] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG per Arsim e Kulturë), 2008,

https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 96 (qasja më 13 qershor 2016).

[50] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 96 (qasja më 13 qershor 2016).

[51] Eurydice "Higher Education Governance in Europe: Policies, structures, funding and academic staff," Komisioni Evropian (DG për Arsim e Kulturë), 2008, https://www.utwente.nl/bms/cheps/summer_school/literature/eu%20reforms%20eurydice%202008%20report.pdf, faqe 98 (qasja më 13 qershor 2016).

[52] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rregulla dhe procedura të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 29 prill 2010, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_2.pdf, Neni 69, paragrafi 4 (qasja më 14 qershor 2016).

LISTA E PUBLIKIMEVE:

Zgjedhjet & Partitë Politike

#1 Instituti D4D. Shtator 2011 Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.

#2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?

#3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën

#4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?

#5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.

#6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero

#7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike

#8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje

#9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit

#10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi, Shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor

Rekomandimet e Forumit Reforma

#1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së

#2 Hartuar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor

#3 Hartuar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve

#5 Hartuar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandimet për Zgjedhjen e Presidentit të Kosovës

#6 Mbështetur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për reformë të mirëfilltë zgjedhore

Marrëdhëniet ndëretnike

#1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade

#2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.

#4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D

#5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D

#6 Ejdus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt një ekuilibri të ri? Publikuar bashku CEPI, BCSP dhe D4D.

#7 Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërqeli. Me kontribut nga: Shpend Emini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Tetor 2016. Gratë e fuqizuara: çelës për transformimin e komuniteteve

Interesi Publik

#1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. 'Taksa' e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë

#3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik

#4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë

#5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?

#6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikat, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra

#7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mission i mundur?

Memorandume Reaguese

#1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë

#2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive

#3 Instituti D4D. 12 Korrik 2013. Memorandumi reagues Nr. 3 – Kritere të qarta për komuna të reja

#4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz

#5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore

#6 Instituti D4D. Nëntor 2016. Memorandum reargues nr.6 – Reforma zgjedhore

Indikatorët & skenaret

#1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010

#2 Instituti D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë

#3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë

#4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014

Publikime të tjera

#1 Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve mund gjithashtu të gjinden në ueb-faqen tone.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

378.147

Nxitje llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë / punimi u përgatit nga Bernard Nikaj, Leon Malazogu. – Prishtinë : Instituti Demokraci për Zhvillim, 2016. – 61 f. ; 21 cm. – (Seria : Interesi Publik ; 8)

1.Nikaj, Bernard 2. Malazogu, Leon

ISBN 978-9951-608-50-3